



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 20.11.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1269/24, për zyrtarin publik znj. Kosovare Halilaj-Karaxha, Anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtaren znj. Kosovare Halilaj-Karaxha, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimi të një kërkesë me shkrim (DPKI-06-1269/24), përmes së cilës është kërkuar sqarim, nëse ekziston konflikti i interesit për zyrtaren znj. Kosovare Halilaj-Karaxha, e cila është anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, e gjithashtu është e angazhuar si zyrtare në drejtorin e administratës së përgjithshme, duke i'u referuar neni 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Konform nenit 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit (DPKI-06-1432/24).

Lidhur me këtë në përputhje me kompetencat e saj, Agjencia ka zhvilluar hetime duke mbledhur dokumentacione dhe informacione shtesë nga Komuna e Drenasit, me qëllim të sqarimit të situatës së përshkruar nga raportuesi i rastit.

Fillimisht, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pretendimet e raportuesit të rastit i ka trajtuar në kontekst ndalesave apo kufizimeve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili nuk përmban dispozita konkrete të cilat do të mund t'i referoheshin rastit në fjalë.

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përcaktuar se: *"Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës"*.

Me qëllim të sqarimit sa i përket kufizimit për nëpunësit civil të administratës së komunës të përcaktuar me nenin 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të cilit i është referuar raportuesi, Agjencia ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Administratës në Komunën e Drenasit, e cila në përgjigjen e saj ka theksuar se: *"... Kosovare Halilaj-Karaxha nuk është zyrtare në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, rrjedhimisht nuk ka as aktemrim pasi nuk shërben dhe nuk është e punësuar si shërbyese civile. E njëjta është e angazhuar përmes kompanisë private "K.H" dhe që përmes kësaj kompanie ofron shërbime administrative dhe kryen punë që kërkojnë sipas nevojës."*

Referuar sqarimeve nga Komuna e Drenasit, si dhe kontratës së punës të znj. Halilaj-Karaxha, e njëjta nuk ka marrëdhënie pune me Komunën e Drenasit, porse ofron shërbime administrative në bazë të kontratës së lidhur sipas Ligjit të Punës, ndërmjet saj dhe kompanisë "K.H", e cila kompani ofron shërbime për Komunën e Drenasit, dhe atë sipas Kontratës Publike Kornizë-Shërbime Nr. 611-22-6059-2-1-1/C571.

Prandaj, duke pas parasysh faktin se e njëjta nuk ka pozitën e shërbyesit civil pasi që nuk ka marrëdhënie pune me Komunën e Drenasit dhe nuk merr pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës, për ofrimin e shërbimeve administrative, dispozita e nenit 65, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nuk aplikohet në rastin konkret.

II. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit